- ✚ Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Bujqësisë përmes subvencioneve ka ndihmuar **250** fermerë me paisje të ndryshme bujqësore, në menyrë që të krijohen kushte me të mira të punës:

1. Freza (125) copë
2. Spërkatëse 400 L (33 *copë*)
3. Mikser për përgaditjen e ushqimit të kafshëve (5 *copë*)
4. Mbjellëse e grurit 16 rendëshe (10 *copë*)
5. Grabuja me traka me kardan (20 *copë*)
7. Rotokosa (44 *copë*)
8. Mbjellëse dy rendore e patates (4 *copë*)
9. Mbjellëse 5 rendëshe e qepujkave (4 *copë*)
10. Nxjerrëse e patates/qepës një rendore (4 *copë*)

Janë përkrahur 10-20 fermerë me projektin “Ngritja e pemishtës me mjedër” me sipërfaqe totale 2ha nga 0.10 deri në 0.20ha.

Mbështetja financiare e projektit është 29,600.00 Euro.

Poashtu janë subvencionuar 5 kërkesa urgjente individuale nga fermerë në vlerë totale prej 8,000 euro.

- ✚ Nga Drejtoria janë ndihmuar **1877** fermerë për përgaditjen e dokumentacionit dhe aplikim në sistemin elektronik eFR gjatë afateve të subvencioneve të shpallura nga MBPZHR, me gjithsej **9000ha** të mbjellura nga kultura të ndryshme bujqësore.

- ✚ Totali i mjeteve financiare, subvencione nga Drejtoria e DBPH-së: **270.000.00 Euro.**

- ✚ Vlera totale e kontratave të nënshkruara për investime kapitale për vitin 2024/2026 : **811,907.94 € , 10 mijë metra kanal te ujitjes, deri tash janë ndërtuar 7500metra.**

Si përfundim ,nga rezultati i këtyre angazhimeve, objektivat e planifikuara për vitin raportues janë arritur në masë të kënaqshme, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve për fermerët, zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe forcimin e rolit të Drejtorisë së Bujqësisë në nivel lokal.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

Zyra komunale per komunitete dhe kthim - Opçtinska kancelarija za zajednice i povratak -
Municipal community and return office

Raporti vjetor për vitin 2025/Godišnji izveštaj za 2025 god.

Numri i përgjithshëm i familjeve të riatdhesuar dhe individëve të vitin 2025 ne ZKKK/
Ukupan broj repatriranih porodica i lica u 2025 god je :

Nr.r/ R.br.	Perkatsia etnike/ Etnička pripadnost	Nr. i familjave te riatdhesuar/ Br. Repatr.porodica	Nr. i ant. familjes / Br. čl. porodice
1	Shqiptar/ Albanci	4	5
2	Rom/ Romi	4	3
3	Egjiptas/ Egipćani	2	
4	Ashkali/Aškalije	3	8
5	Boshnjak/Bašnjaci	1	
Gjithsejt/ Ukupno		14	16
		30	

Numri i familjeve të riatdhesuar dhe individvë ne vitin 2025. sipas përkatësisë etnike dhe vendit te deportimit/
 Broj repatriranih porodica i lica u 2025 god. prema etničkoj pripadnosti i zemlji deportovanja :

Nr.r/ R. br.	Shteti/ Država	Perkatsia etnike/ Etnička Pripadnost		Perkatsia etnike/ Etnička Pripadnost		Perkatsia etnike/ Etnička Pripadnost		Perkatsia etnike/ Etnička Pripadnost		Perkatsia etnike/ Etnička Pripadnost		Gjithsej/ Ukupno	
		Shqiptar/ Albanci		Rom/ Romi		Egjiptas/ Egipćani		Askali/ Aškalije		Boshnjak/ Bošnjaci		Nr. i familjeve / Br. porodica	Nr. i ant. familjes / Br. čl. porodice
		Nr. i familjeve / Br. porodica	Nr. i ant. familjes / Br. čl. porodice	Nr. i familjeve / Br. porodica	Nr. i ant. familjes / Br. čl. porodice	Nr. i familjeve / Br. porodica	Nr. i ant. familjes / Br. čl. porodice	Nr. i familjeve / Br. porodica	Nr. i ant. familjes / Br. čl. porodice	Nr. i familjeve / Br. porodica	Nr. i ant. familjes / Br. čl. porodice		
1	Gjermani/Nemačka	3	5	4	3	2		2	3				
2	Zvicra/Švajcarska	1						1	5				
3	Islanda/Island									1			
GITHSEJ/ UKUPNO		4	5	4	3	2		3	8	1		14	16
												30	

Kerkesa për akomodim/Zahtev za smeštaj				
Perkatsia etnike/ Etnička Pripadnost	Të aplikuar/ Prijavljeno	Të refuzuar/ Odbijeno	Aprovuar/ Odobreno	Në pritje/ Na čekanje
Egjiptas/ Egipćani	2		2	
Rom/Romi	1		1	
Gjithsej/Ukupno	3		3	

Kerkesa për dru zjarmit /Zahtev za drva za ogrev				
Perkatsia etnike/ Etnička Pripadnost	Të aplikuar/ Prijavljeno	Të refuzuar/ Odbijeno	Aprovuar/ Odobreno	Në pritje/ Na čekanje
Egjiptas/ Egipćani	1		1	
Gjithsej/Ukupno	1		1	

Kerkesa për pako ushqimore dhe higjenike /Zahtev za paket za hranu i higijenu				
Perkatsia etnike/ Etnička Pripadnost	Të aplikuar/ Prijavljeno	Të refuzuar/ Odbijeno	Aprovuar/ Odobreno	Në pritje/ Na čekanje
Egjiptas/ Egipćani	1			
Romë/Romi	1			
Gjithsej/Ukupno	2			

**Pasqyrë statistikore të personave të riatdhesuar sipas moshës dhe gjinisë/
Statistički pregled repatriranih osoba prema god. starosti i polu**

Perkatsia etnike/ Etnička Pripadnost	0-5		6-13		14-17		18-34		35-64		65		GJITSEJ/ UKUPNO	
	Meshkuj/ Muškarci	Femra/ Žene	Meshkuj/ Muškarci	Femra/ Žene	Meshkuj/ Muškarci	Femra/ Žene	Meshkuj/ Muškarci	Femra/ Žene	Meshkuj/ Muškarci	Femra/ Žene	Meshkuj/ Muškarci	Femra/ Žene	Meshkuj/ Muškarci	Femra/ Žene
Shqiptar/ Albanci			1	3			1	1	2	1			4	5
Rom/ Romi				3			1		2	1			3	4
Egjiptas/ Egipćani									1			1	1	1
Ashkali / Aškalije	1	2		2	1	1	1	1		2			3	8
Boshnjak/ Bošnjaci									1				1	
GJITSEJ/ UKUPNO													12	18
													30	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS PEJË

I. Numër: 01-016/01-9246

Pejë, datë: 26 Shkurt 2026

PROCESVERBAL

Nga takimi i **–I- rë** i rregulltë i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me: **26 shkurt 2026** me fillim në orën 10:00 h.

Takimi u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Në takim prezantojnë: përpos anëtarëve të kuvendit të komunës, kryetari i komunës z. Gazmend Muhaxheri, nënkryetari z. Fatmir Asllani; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj; drejtorët e SHCK-së, z. Avni Gashi, udhëheqës i sektorit të kuvendit, zyrtare administrative znj. Donjeta Morina; përfaqësues të ZIP-it, përfaqësuesit të OJQ-ve dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike.

Në vazhdim takimin e kryesoi; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, ku e hapi diskutimin për rendin e ditës dhe i sqaroi pikat të cilat janë vendosur në rend dite, pastaj konstatoj se janë 34 anëtarë prezent.

Me kërkesë të asambleistit z. Drin Veselaj, kuvendi mbajti një minutë heshtje për të ndjerin prof. Sadik Berisha.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent, u miratua ky rend dite me propozimin që u dha nga kryesuesi:

REND DITE

1. Aprovimi i rendit të ditës.
2. Betimi i anëtareve të Kuvendit, Bekim Morina, Dafina Dragaj, Atdhe Berisha, Shqiprim Muriqi, Muamel Dupljak, Shkembim Prakaj, Elbasan Krasniqi, Islam Husaj, Kaltrina Lajqi, Gentiana Bajrami Atashi, Gemza Sylejmani, Hidajete Nikçi, Drin Veselaj, Ilirjane Gafuri.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 29.09.2025. dhe Procesverbalit nga Seanca Inauguruese e dt. 10.12.2025.
4. Themelimi i Komitetit për Politik e Financa.
5. Themelimi i Komitetit për Komunitete.
6. Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSBB.
7. Emërimi i Nënkryetarit të Komunës për Komunitete.
8. Themelimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P.L.”STACIONI I AUTOBUSAVE” SH.A. Pejë.
9. Themelimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P.L.”AMBIENTI” SH.A. Pejë.
10. Themelimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P.L.”EKO - SIG” SH.A. Pejë.
11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për listën së veçantë të pronave Komunale të Komunës së Pejës që do të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026.
12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryesuesit për dhënien e autorizimit DKRS-së nga Kuvendi për publikimin e konkursit publik për tituj nderi, dekorata, mirënjohje dhe falënderime.
13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryesuesit për formim e komisionit të veçantë për ndarjen e titujve të nderit, dekoratave, mirënjohjeve dhe falënderimeve nga Kuvendi i Komunës Pejë.
14. Shqyrtimi dhe zgjedhje a delegatëve për Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës nga Komuna e Pejës.
15. Shqyrtimi dhe zgjedhja e zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete.
16. Informata e Kryetarit mbi gjendjen ekonomiko – financiare në Komunën e Pejës
17. Shqyrtimi i informatës mbi planifikimin e Prokurimit për vitin 2026.
18. Shqyrtimi i informatës së kryetarit mbi planin e punës së ekzekutivit për 2026.
19. Shqyrtimi i informatës mbi raportin vjetor të Komunës se Pejës për vitin 2025.

20. Shqyrtimi i raporti informativ i të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2025.
21. Shqyrtimi i informatës mbi realizimin e Planit të Prokurimit për vitin paraprak.
22. Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:
23. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.

Në takim mungoi z.Berat Ganiqi.

2.Pjesëmarrja publike dhe delegacionet

Nuk ka pasur.

3. Betimi i anëtareve të Kuvendit, Bekim Morina, Dafina Dragaj, Atdhe Berisha, Shqiprim Muriqi, Muamel Dupljak, Shkembim Prakaj, Elbasan Krasniqi, Islam Husaj, Kaltrina Lajqi, Gentiana Bajrami Atashi, Gemza Sylejmani, Hidajete Nikçi, Drin Veselaj, Ilirjane Gafuri.

Anëtarët e kuvendit të cilët u betuan pas procedurës së zëvendësimit nga KQZ janë: Bekim Morina, Dafina Dragaj, Atdhe Berisha, Shqiprim Muriqi, Muamel Dupljak, Shkembim Prakaj, Elbasan Krasniqi, Islam Husaj, Kaltrina Lajqi, Gentiana Bajrami Atashi, Gemza Sylejmani, Hidajete Nikçi, Drin Veselaj, Ilirjane Gafuri.

4.Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 29.09.2025. dhe Procesverbalit nga Seanca Inauguruese e dt. 10.12.2025.

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent u miratuan procesverbalet e seancës së kuvendit dt. 29.09.2025 dhe Procesverbali nga Seanca Inauguruese e dt. 10.12.2025.

5.Themelimi i Komitetit për Politik e Financa.

Kryesusi Rexhep Kurboqaj: KPF- ja përbëhet prej nëntë anëtarëve dhe numri i anëtarëve përcaktohet sipas numrit të pjesëmarrësve të anëtarëve të subjekteve politike. Sipas formule së

kaluar kryesusi i kuvendit me automatizëm është pjesë e KPF-së. Pastaj tre anëtar i takojnë subjektit të LDK, dy anëtar nga AAK, dy anëtar nga LVV, dhe një anëtar nga PDK.

Nga subjektet politike të lartëpërmendura nga Kryesuesi, u propozuan emrat si në vijim:

Arben Morina- LDK

Bekim Morina- LDK

Kaltrina Lajqi- LDK

Naim Bytyqi- AAK

Labinot Panxha- AAK

Ardit Berisha- LVV

Valbona Gjakova Taraku-LVV

Edonjeta Berisha-PDK

Nga të gjithë anëtares prezent 32 votë pro, dy anëtarë të përmbajtur, u miratua Themelimi i Komitetit për Politik e Financa.

6.Themelimi i Komitetit për Komunitete.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: gjithashtu edhe ky komitet si trup e kuvendit është komitet i përhershëm dhe përbëhet nga nëntë anëtarë. Shumica e këtyre anëtarëve përbëhet nga minoritetet. Nga kuvendi i takon një anëtar nga subjekti LDK, një anëtar nga subjekti AAK, një anëtar nga subjekti LVV dhe dy anëtar nga partit e radhëve të minoriteteve që janë pjesë e kuvendit. Antarë të tjerë që janë pjesë e këtij komiteti, i kemi mar emrat të cilat janë ardh të dorëzuar me shkrim në kuvend dhe i kemi propozuar në këtë komitet. Në këtë seancë do ti zgjedhim edhe anëtares e tjerë të kuvendit që të jenë pjesë e këtij komiteti.

Nga subjektet politike të lartëpërmendura nga Kryesuesi, u propozuan emrat si në vijim:

Dafina Dragaj, anëtare e kuvendit nga subjekti politik	- LDK
Vjendita Kelemndi Gergoci, anëtare e kuvendit nga subjekti politik	- AAK
Mubera Belegu, anëtarë i kuvendit nga subjekti politik	- LVV

Muamel Dublljak, anëtarë i kuvendit nga subjekti politik - BSK
Mirsad Berisha, anëtarë i kuvendit nga subjekti politik - PLE

Miloš Dimitrijević, përfaqësues i komunitetit serb,
Omer Dacić, përfaqësues i komunitetit boshnjak,
Edmir Delija, përfaqësues i komunitetit egjiptian,
Sofije Toska, përfaqësuese e komunitetit romë.

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent, u miratua Themelimi i Komitetit për Komunitete.

7. Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSBB.

Kryesuesi Rexhep Kurbogaj: KKSBB është një trupë mbështetëse që marrin pjesë kryetari i komunës, nënkryetarët, drejtorë të drejtorive, përfaqësues të bashkësive fetare dhe partner të tjerë të cilët mbajnë takime të rregullta gjatë vitit, që ka të bëjë mbi gjendjen e sigurisë brenda Komunës së Pejës. Çdo mandat duhet të rithemelohej KKSBB-ja, edhe në këtë seancë e kemi sjellë të miratohet nga kuvendi komunal. Në material i keni edhe emrat e propozuar për anëtarët e KKSBB-së.

Z.Ardit Berisha: Përshëndetje për të gjithë! Më intereson të di se si ka shkuar përzgjedhje ose propozimi i këtyre emrave edhe konkretisht nga mediat lokale si ka shkuar përzgjedhja e emrit?

Z.Fatmir Asllani: përzgjedhja ka shkuar përmes thirrjes publike, ka qenë e hapur thirrja publike dhe të gjithë edhe komitetet tjera jo shumicë kanë aplikuar, por edhe nga shoqëria civile dhe nga mediat. Përzgjedhja është bërë prej komisionit që është i formuar brenda në komunë.

Nga të gjithë anëtarët prezent 33 votë pro, një anëtar i përmbajtur, u miratua Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSBB.

8. Emërimi i Nënkyetarit të Komunës për Komunitete.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: propozimin për emer të nënkryetarit të Komunës për Komunitet po ja kalojmë fjalën kryetarit!

Kryetari Gazmend Muhaxheri: për nënkryetar për komunitet propozoj z.Mirzet Džogović. Ka qenë edhe deri tani nënkryetar dhe propozoj të votohet prap.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: fillimishtë duhet të marrë miratimin e shumicës së anëtrëve të kuvendit. Pastaj pas këtij miratimi duhet të marrë edhe miratimin e dy subjekteve nga radhët e minoriteteve që të jet i zgjedhur si nënkryetar për komunitete.

Z. Labinot Panxha: përshendetje të pranishëm në sallë dhe në veqanti ju kolegë që sapo u betuat në këtë mandat katërvjeçar. Shpresoj shumë që nuk do ta shkelni betimin qysh në këtë pikë të rendit të ditës. Sidoqoftë për dijenin e qytetarëve në këtë pikë të rendit të ditës, qysh e tha edhe kryesusi po dikutohet për emërimin e nënkryetarit të komunës që vjen nga komunitete jo shumicë. Bazur në dispozitat e ligjit për vetëqeverisje lokale, konkretishtë neni 61 paragrafi 61.1 komunat ku të pakten 10% e qytetarëve i përkasin komuniteteve, jo shumicë do ta kenë një nënkryetar për komunitete. Mirëpo nese i referohemi të dhënave nga agjensia e statistikave të Kosovës, konkretishtë regjistrimit të fundit të popullsisë të regjistruar në vitin 2024 numri i popullësisë në Pejë është 82.745 banorë prej tyre nga komuniteti jo shumicë janë të regjistruar serbë janë 813, boshnjakë janë 2974, turq janë 28, romë janë 889, ashkali janë 309, egjiptian janë 1916, goran janë 192, dhe të tjerë janë 91. Gjithësej komuniteti jo shumicë janë regjistruar 7212 banorë. Nese e kthejmë në përqindje, komuniteti serb përbëhet nga 2.3% dhe komitetet tjera përbëjnë 5.9% të popullësisë në Pejë. Që në këtë rast në total i bjen me kanë komunitete 8.2%. Nese i referohemi këtyre statistikave, as nënkryetari i komunës dhe as nënkryesusi i kuvendit nuk i takon komuniteteve jo shumicë në Pejë. Prandaj kërkoj nga propozuesi në këtë rast kryetari i komunës që ta rishkoj edhe njëhere dhe ta tërheq nga ky rend dite propozimin e tij. Për korrektësi me lejon që t'ju them se ne si subjekt nuk kemi asgjë kundër këtyre komiteteve por vetem që jemi kundër veprimet të kundërligjshme. Për këtë arsye vota jonë do të jetë gjithmonë kundër këtyre veprimeve të cilat janë kthyer në një fenomen të rëndom nga parita në pushtet, e cila shpresoj shumë që në këtë mandat do të reflektoj dhe do të punoj konform kornizave ligjore, duke i pëmbushur objektivat të cilat ju takojnë dhe të cilat çojnë në një mirëqenie dhe zhvillim më të mirë të qytetit ku ne jetojmë.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: unë ju ftoj me votu, askund ligji nuk e ndalon ne me i promovu minoritetet dhe vlerat e tyre. Dhe është nder me pas një nënkryetar si Mirzeti në kuvendin e komunës Pejës. Ne e kemi pas edhe në të kaluaren dhe MAPL është që i vleron ligjëshmëritë e akteve që i nxjerr asambleja komunale e Pejës.

Z.Ardit Berisha: pa dashur me shtu shumë se çka tha Labinoti dhe me u përserit Neni 61 i ligjit për qeverisje lokale e thotë që komunat ku të paktën 10 % të qytetarëve i përkasin komuniteteve jo shumicë duhet të kenë nënkryetar të komunës. Andaj ligji është i qartë, dispozita është taksatative dhe unë mendoj që kuvendi komunlka nëse votojnë sot pro bëjnë shkelje të ligjit.

Z.Bekim Morina: e lexuat nenin, por neni nuk tha nuk duhet nëse janë edhe më pak. Por nëse ka të bëjë me promovimin e vlerave dhe afrimin e minoriteteve unë besoj që nuk ka kurgjo të kundërligjshme.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: udhëzimi administrativ nga MAPL 2020 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve nëpër komuna neni 5 paragrafi 2 thotë: Në komunat ku pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë janë më pakë se 10%, më qëllim të promovimit të të drejtave të komuniteteve jo shumicë, sipas mundësive financiare, komunat mundë të emërojnë një nënkryetar për komunitete.

Sipas procedurës duhet të votohet edhe nga radhët e komuniteteve, nese janë të gatëshem ta votojnë.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 20 votë pro, 13 votë kundër, një anëtar nuk ka marr pjesë në votim, miratohet Emërimi i Nënkyetarit të Komunës për Komunitete.

9.Themelimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P.L.”STACIONI I AUTOBUSAVE” SH.A. Pejë.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: komuna si aksionare e kësaj kompanie obligohet që t'i propozojë kuvendit për dy anëtarët e komisionit që duhet të emrohen nga radhët e kuvendit. Gjithashtu edhe një anëtar që propozohet nga kryetari i komunës.

Anëtarët e propozuar nga dy subjektet politike, janë si mëposhtë:

Arsim Selmonmusaj - LDK

Albi Shala - PDK

Z.Drin Veselaj: sipas rënditeje së grupve parlamentare ne jemi grupi i dytë edhe nuk po di ju kur ju konvenon, po e kaperceni të dytin e të tretin. Kështu që kjo komisioni i aksionarëve është të

mirën e qytetarëve, nuk është veç në të mirën e pushtetit. Edhe kjo ka dëshmuar edhe në të kaluarën që aty ku kemi marrë ne pjesë si opozite nuk keni pasur telashe ligjore, e aty ku s'kemi qenë na keni pasur goxha shumë dhe ju ka shku mandati nëpër gjykata për këto komisione.

Z.Labinot Panxha: si transparencë e kam një pyetje se ku po bazohen ju që duhet me i tejkalu grupet në asamble? Nese shkojmë me rënditje i bjen LDK, AAK, VV, PDK. Nese nuk shkojmë kështu ku po bazohesh që nuk duhet me shku qështu? Nëse nuk ka prej opozites anëtarë në këto komisioni qka i bjen kjo? A po ikni apo frigoheni apo si tha Drini duhet prap me shku dikush aty që dikton si me vepru e pastaj me ju thirrë prokuroria me ngrit aktakuza, nuk e kam të qartë!

Kryetari Gazmend Muhaxheri: Labinot, me ti shkurtu mendimet për ketë punë bëhen koalicionet dhe ne e kemi koalicionin me PDK dhe i kemi votat e i kalojmë këto dhe për me i zhvillu politikat që ne dojmë me i zhvillu.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 20 votë pro, 13 votë kundër, miratohet Komisioni Komunal i Aksionarëve të N.P.L.”STACIONI I AUTOBUSAVE” SH.A. Pejë.

10.Themelimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P.L.”AMBIENTI” SH.A. Pejë.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: janë tre anëtar pjesë e ketij komisioni, një anëtar nga kryetari , dy anëtarë duhet të jenë të propozuar nga kuvendi dhe të miratohen këtu.

Anëtarët e propozuar nga dy subjektet politike, janë si mëposhtë:

Atdhe Berisha- LDK

Albi Shala- PDK

Z.Drin Veselaj: e kam të pa qartë unë një seancë kam munguar në asamble, mos keni themeluar ndonjë ndërrmarje tjetër se qekjo N.P.L “Ambienti” është ndërrmarje publike lokale, me sa e dim na kjo është KRK “Ambienti” është ndërmarrje regjinoale ku është edhe Klina edhe Istogu. Nese keni themeluar ndonjë veç me na tregu kryetar ju po thuani që është NPL, në pjesen tjetër ne e dim që edhe Klina ju përgjigjet edhe ka përgjegjësi. Mirë kishte me qenë me na sjellë dokumentacionin e NPL-së edhe me pa na statutin, aktin e themelimit dhe të gjitha. Për shkak se ne e dim që kjo është KRK “Ambienti” dhe jo NPL “Ambienti”vetem të jemi të qartë!

Kryetari Gazmend Muhaxheri: është ndërmarrje publike lokale janë kry krejt procedurat, edhe pse i keni pas ky ju njëher e nuk janë përfundu, e ne nga ana e komunës i kemi përfundu gjitha procedurat dhe nuk kemi të bëjmë as me Istogun as me Klinen.

Z.Ardit Berisha: para se me kalu te votimi ne e kuptojmë që koalicionet bëhen, fillimisht të urojmë koalicionin me PDK-në, sespe ne nuk e kemi ditur a me PDK-në a me AAK-në. Mirëpo paske vendos edhe këtë mandat me PDK-në urime! Por është e drejt demokratike edhe në bazë të rregullores së kuvendit që edhe subjektet tjera me pas të drejten e propozimit. Edhe pse ne kuptojmë që votoni kundër por se paku me pas të drejten me propozu dhe për këtë arsye propozoj z.Besnik Zeqiraj për anëtar të ketij bordi.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: i kemi tre anëtar të propozuar dhe dy prej tyre duhet të jenë pjesë e ketij komisioni, dhe po i qesim në votim emrat veq e veq!

Anëtarët e propozuar:

Atdhe Berisha-LDK

Nga të gjithë anëtarët prezent me 20 votë pro, 8 kundër miratohet propozimi i parë.

Albi Shala-PDK

Nga të gjithë anëtarët prezent me 20 votë pro,8 kundër miratohet propozimi i dytë.

Besnik Zeqiraj-LVV

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 19 votë kundër , 1 votë abstenim, nuk kalon.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: z.Albi Shala dhe z.Atdhe Berisha, janë anëtarët që do të jenë pjesë e ketij komisioni.

11.Themelimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P.L.”EKO - SIG” SH.A. Pejë.

Anëtarët e propozuar nga dy subjektet politike, janë si mëposhtë:

Kaltrina Lajqi-LDK

Arta Vokshi Nallbani- PDK

Nga të gjithë anëtarët prezent me 20 votë pro, 5 votë kundër, miratohet Themelimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P.L.”EKO - SIG” SH.A. Pejë.

12.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për listën së veçantë të pronave Komunale të Komunës së Pejës që do të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026.

Kryesusi Rexhep Kurbogaj: në materialin që e kemi përcjellë ju kemi dërguar edhe listen e cila ka ardh nga ekzekutivi, që janë të paraqiturat pronat, objektet që janë të planifikuara me u dhënë në shfrytëzim gjatë këtij viti. Ka qenë një afat deri në fund të vitit mirëpo për shkak të zgjedhjeve dhe procedurave të tjera është shty dhe jemi brenda afatit me paraqitjen e kesaj liste të pronave.

Z.Labinot Panxha: vetem për shkak të procedurës mendoj që lista e pronave duhet të procedohet në komitet për politikë dhe financa, meqenëse afati është i përcaktuar në mars me kalu në kuvend, po besoj që e nxini edhe afatin . Kishte me qenë mirë me zbatu këto procedura sepse mundet me ju kthy, ndoshta i këmbeni e krejt se i keni votot por MAPL ju kthen prapa për shkak se keni kalu një procedurë.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: janë prona që kryesisht janë dhënë vetem një është risi është prona që ja kemi jep qeverisë ose ministrisë planifikimit hapsinor me ndërtu banimin e përballushem. Na mbet neve aty një pronë dhe kishte me qenë mirë me qit ne trajtim dhe me jep për ndërtim partneritet publiko privat, me i marr disa banesa komuna, mandej mundem me i shfrytëzu si asete për këmbim me prona tjera që i duhen komunës.

Z.Ardit Berisha: lidhur me çështjen e pronave dhe dhënies në shfrytëzim, unë ju kam drejtuar me një kërkesë kryetarit , lidhur me ndërmarrjen publike mbasi vi nga aty po e shfrytëzoj rastin edhe ulësen e asambleistit. E kemi me 16 dhjetor 2025 një listë të pronave të cilat ndërmarrja i ka në shfrytëzim apo në posedim, dhe nuk e di pse kryetari nuk i ka përfshi në këtë listë kisha pas dëshir me marr një arsyje?

Kryetari Gazmend Muhaxheri: pasi që ndërmarrja është publike dhe qeveritare kemi pasur nevoj me negociuar pak me qeverinë dhe ishalla jeni të vullnetit me ndërmjetësu. Qeveria i ka do obligime me j’a kry komunës, mandej edhe ne kryjmë andej ndërmarrjet qeveritare.

Z.Ardit Berisha: ne jemi taku dhe ke thënë që për këtë çështje nuk ka ardh kërku me kërku, dhe mendoj që kjo çështje është administrative dhe teknike , për shkak që edhe administratën që

e kemi Hidro Drini e kemi në tokë të komunës. Andaj kalkulimet politike në këtë rast po me doken jo të singerta dhe jo serioze nga ana juaj, për shkak se edhe ndërmarrja jonë publike është për të miren e qytetarëve në shëbim të qytetarëve. Ju e dini se të gjitha komunikimet dhe të gjitha punët, gjitha prishjet që i kemi pas kanë shku në mënyrë të rregulltë. Aty e keni edhe vëllau dhe të takon ndoshta edhe për shkak të vëllaut, kështu që përfshije se keto kalkulime nuk janë në rregullë.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 20 votë pro, 7 votë kundër, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për listën së veçantë të pronave Komunale të Komunës së Pejës që do të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026.

13.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryesuesit për dhënien e autorizimit DKRS-së nga Kuvendi për publikimin e konkursit publik për tituj nderi, dekorata, mirënjohje dhe falënderime.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: çdo vit duke ju përmbajtur procedurave kryetari ka të drejtë që të jep dekorata, mirënjohje, dhe tituj nderi për personalitete që i takojnë qytetit të Pejës. Paraprakishtë ju nënshtrohen procedurave të cilat fillojnë nga kuvendi, pastaj tek DKRS. Në këtë rast sipas kësaj pike që e kemi paraqitur duhet me shumicë të votava të anëtarëve të kuvendit të autorizohet DKRS, për publikimin e konkursit publik për ata që konkurojnë për mirënjohje, dekorata dhe falenderime të cilat do të jepen gjatë këtij viti.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 32 votë pro, një anëtar nuk ka marr pjesë në votim, miratohet propozimi i Kryesuesit për dhënien e autorizimit DKRS-së nga Kuvendi për publikimin e konkursit publik për tituj nderi, dekorata, mirënjohje dhe falënderime.

14.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryesuesit për formim e komisionit të veçantë për ndarjen e titujve të nderit, dekoratave, mirënjohjeve dhe falënderimeve nga Kuvendi i Komunës Pejë.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: komisioni përbëhet nga 7 anëtar, nga një anëtar nga subjektet politike, një anëtar nga ekzekutivi dhe një anëtar i propozuar nga shoqëria civile.

Anëtarët e propozuar, nga subjektet politike në kuvend janë si më poshtë:

1. Gentiana Bajrami Atashi- LDK
2. Ilir Gashi –AAK
3. Besnik Zeqiraj-LVV
4. Edonjeta Berisha- PDK
5. Muamel Dubpjak-BSK

Ndersa nga Ekzekutivi do te jetë Xhenet Syka Kelmendi.

Si dhe nga takimi me shoqërinë civile është propozuar z. Agim Haxhijaj

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent miratohet propozimi i Kryesuesit për formim e komisionit të veçantë për ndarjen e titujve të nderit, dekoratave, mirënjohjeve dhe falënderimeve nga Kuvendi i Komunës Pejë.

15. Shqyrtimi dhe zgjedhje a delegatëve për Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës nga Komuna e Pejës.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: anëtarët që duhet të marrin pjesë janë kryetari i komunës, kryesusi i kuvendit, një anëtar nga LDK, një anëtar nga AAK, një anëtar nga LVV.

Anëtarët e propozuar, nga subjektet politike ne kuvend janë si më poshtë:

Kryetari Gazmend Muhaxheri

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj

Islam Husaj-LDK

Shaban Ramaj-AAK

Berat Ganiqi- LVV

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent miratohet zgjedhje a delegatëve për Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës nga Komuna e Pejës.

16.Shqyrtimi dhe zgjedhja e zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: ne po e propozojmë z.Mirsad Berisha si një aktivist i palodhshëm dhe mendojmë që e meriton këtë titullë.

Z.Labinot Panxha: për mos mu bo i tepërt në piken ku u propozua nënkryetari i komunës dhe duke ju referuar aktit nënligjor, udhëzimit administrativ i cili është i shfuqizuar që tre vite. Për korektësinë qytetarëve unë po dua me ju bë me dije që udhëzimit administrativ të cilit ju i referove është shfuqizu me dispoziten e nenit dhe të nenit administrativ 03/2023 për procedurën e emërimit të nënkryetarit të komunës. Neni 5 e përcakton qartë në komunat ku së paku 10% të qytetarëve i përkasin komuniteteve jo shumicë emërimi i nënkryetarit për komunitete është i obligueshëm. Unë si mik po të këshilloj që të këshillohesh me jurist profesionistë në mënyrë që mos me dal keq! Ju referove një dispozite, ju referove një akti nënligjor të shfuqizuar tre vite më heret.

Z.Ardit Berisha: edhe kjo njejtë si te nënkryetari i komunës edhe kjo është e kundërligjshme. Ligji për qeverisje lokaale edhe ktu e parasheh që së paku 10% të qytetarëve që i përkasin komunitetit jo shumicë në një komunë. Pra nuk thotë më pak se 10 por thotë me së paku 10% që nënkupton që duhet me u arrit 10 % i qytetarëve që jetojnë në atë komunë, për me ju taku nënkryetari i komunës dhe zëvend kryesusi i asamblesë.

Z.Muamel Dubpjak: kur po folin për nenin 5 ky është i fundit prej 2023-es për nënkryetar të komunave. Ku neni 5 pika 2 thotë: ku pjesëmarrja e komuniteteve jo shumicë janë më pak se 10%, me qëllim të promovimit të të drejtave të komuniteteve jo shumicë sipas mundësive financiare komunat mund të emrojnë një nënkryetar për komunitete.

Z.Ardit Berisha: ne nuk jemi kundër komuniteteve se sa ma shumë përfaqësim të ketë aq ma mire është për neve. Por normalishtë që edhe ne si jurist dhe mbasi po flasim si jurist ne ketë rast nuk dëshirojmë me lënë komunën dhe kuvendin komunal me gabu për shkak se kthehen. Nuk jemi ne ata që e mbikqyrim, ligjshmërinë e mbikqyrë ministria përkatëse, ju vazhdoni me propozimin e juaj!

Kryetari Gazmend Muhaxheri: ne e kemi pas edhe në mandatin e kaluar përfaqësues i komunitetit boshnjak i parties që ka qenë në qeveri. Nuk është kthy negative kjo punë por është

promovim i vlerave dhe promovim i komunitetit. Komuna e Pejës është në gjendje të mire financiare dhe mundet me i bo këto punë dhe është vullnet i mire me i pas përfaqësues edhe komunitete. Ne e dim që statistikën po dalin 8.8 por një pjesë e tyre ska mujt me dal me u regjistru sepse realisht janë mbi 15% në komunën e Pejës.

Zëvendëskryesues i kuvendit :

Mirsad Berisha

Nga të gjithë anëtarët prezent me 20 votë pro, 11 votë kundër, një votë e përmbajtur, miratohet zgjedhja e zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete.

17. Informata e Kryetarit mbi gjendjen ekonomiko – financiare në Komunën e Pejës.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: sipas raportit financiar për periudhën janar-dhjetor 2025 në komunën e Pejës paraqitet një gjendje e përgjithëshme stabile ekonomike financiare. Me performancë pozitive në shumicën e sektorëve. Komuna vazhdon të ketë trend të qëndrueshëm në menaxhimin e financave dhe realizimin e objektivave buxhetore. Duke reflektuar stabilitet dhe efikasitet në administrimin e të hyrave dhe shpenzimeve. Komuna e Pejës vazhdon të ketë trend pozitiv në realizimin e të hyrave vetanake për vitin 2025. Ishin të planifikuara 5.6 milion të hyra, ndërsa komuna e Pejës ka realizuar 8.034.77 milionë euro. Që i bjen se tejkalimi buxhetor për vitin 2025 ka qenë 2,202.47 milionë euro të hyra vetanake. Ky tejkalim krijon mundësi për mbulimin e obligimeve të projekteve të vitit 2025 të cilat na i ka marrë përmbartuesi, planifikim dhe buxhetimin e projekteve të reja për këtë vit dhe menaxhimin e shpenzimeve të paplanifikuara, veqanërisht ato që lidhen me vendime gjyqësore si pasojë e kontratës kolektive. Investimet kapitale për vitin 2025 janë realizuar në 87.57% ose 13,170 milion euro. Kategoritë të tjera të shpenzimeve që kanë qenë subvencionet, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet kapitale siq e patë janë realizu në plotëni. Sfidë kryesore gjatë vitin 2025 ka qenë kontrata kolektive dhe ngritja e çmimit që ka qenë për 20% për shumicën e kontratave që janë realizuar gjatë pandemisë. Nga qeveria ka ardh vendimi që duhet me u pagu ajo rritja 20% dhe janë duke u ekzekutuar nga drejtoria për buxhet dhe financa. Deri në fund vit janë realizuar 2,394.82 milion euro denime gjyqësore të cilat kanë qenë kryesisht për shpronësime dhe kontratën kolektive. Disa projekte infrastrukturore janë përballë me vonesa të mëdha për shkak të marrjes së këtyre mjeteve buxhetore prej kontratës kolektive dhe shpronësimeve që i kemi pas gjatë këtij viti.

18.Shqyrtimi i informatës mbi planifikimin e Prokurimit për vitin 2026.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: planin e prokurimit e kemi dërgu me material tek anëtarët e kuvendit dhe kanë secili. Plani i prokurimit bazohet tek projekt buxheti i cili i specifikon punët të cilat duhet të realizohen gjatë këtij viti.

Znj.Valbona Taraku: gjatë shqyrtimit të planit të prokurimit për vitin 2026 i kam hasur disa pika për të cilat kam edhe pyetje. Te pika e 7 është furnizmin me tepiha dhe perde për çerdhe dhe shkolla në vlerë prej 10.000 euro. Pyetja ime është a do të fillojë komuna me i furnizu vërtet shkollat me perde dhe tepih ku deri tash është dashur prindërit me i pagu këto? Pika e 26 është blerja e dy makinave me fshesë për larje dhe fshirja e hapsirave publike në vlerë prej 100.000 euro. A keni vendos me i pastru rrugët edhe me ujë se nuk e mbajmë në mend ku ka qenë hera e fundit që ka ndodhur kjo? Pika 34 makineri bujqësor apo traktor participim për fermer në vlerë prej 500.000euro. sa fermer do të participohen dhe a i ka identifiku drejtorja e bujqësisë këta fermerë? Pika e 35 blerja e kombibusëve për shkolla në vlerë prej 100.000euro. A do të filloni me siguru transportin e nxënësve apo si e keni menduar këtë plan? Nevojten pak ma shumë detaje . Si dhe pika e fundit ndërtimi i QMF-së në lagjen Dardania në vlerë prej 50.000 euro.Pyetja ime është se çka do të ndodh me QMF-në ekzistuese?

Kryetari Gazmend Muhaxheri: po ja nisim prej fundit QMF-në ekzistuese do ta rrënojmë dhe do t'a mbarojmë QMF të re. Për kombibuset nuk janë për transport të nxënësve, por për sportin shkollor. Komuna e Pejës do të ndaj buxhet me i ble 10 kombi për shkolla dhe posaqërishtë për sportin shkollor. Ndërsa fshisat janë për ndërmarjen Eko Sig për fshirjen e rrugëve largimin e pluhurit dhe mbeturinave për punëtorët që punojnë çdo ditë, do të jetë 150 mijë euro do të shtohen edhe 50 mijë euro me rritjen buxhetore. Tek bujqësia trakëtorët bëhen me thirrje, ne kemi propozuar dhe i kemi pas si program qeverisë se do t'i shpërndajmë për fermeret tonë diku rreth 250 traktorë.(për shkak të problemeve teknike dhe debatit interaktiv nuk dëgjohet).

Z.Ardit Berisha: e kam pa planin e prokurimit për vitin 2026 janë disa zëra për kanalet e ujitjes për Lugun e Baranit, unë i kam drejtuar dy kërkesa për fsh.Kryshec dhe fsh.Kosuriq. Duke pasur parasysh se herën e kaluar ka pasur vërshime edhe në Kryshec edhe në Kosuriq, është shumë e nevojshme që në këto dy fshatra të ndërhyret, nese nuk bëhet kanali komplet prej fsh.Kryshec që vjen lumi i Behocit. Sigurishtë që jeni i njoftuar për këto problematika edhe pse nuk ju kemi parë

në terren në Lugun e Baranit ato ditë. Ndoshta nuk ke qenë në Kosovë dhe nuk e di cila është aryeja, mirëpo është mirë që këto dy intervenime të bëhen në Kryshec për shkak se 20 vite qytetarët kanë probleme. Sa here që vjen sezona e dimrit fryhet lumi dhe del jashtë shtratit dhe shkakton dëme! Gjithashtu edhe në Kosuriq nëse nuk e ka planifiku komuna atëherë kisha kërku që me u fut në planifikim.

Z.Tahir Shala: deshta me ju përgjigj se ky djali është shumë aktiv në rrjetet sociale, mas pari kur fol publikishtë duhesh me dit ligje se kush çka menxhon. Pikërishtë Bohocin e menaxhon Drini i Bardhë që bordin e keni zgjedhur ju , siq e din dhe i keni dërgu njerëzit e juaj atje. Ne si komunë ju dalim në ndihmë, vitin e kaluar e kemi pas një bashkëpunim me ta , i kemi financuar ne ata 10 mijë euro për punën që ata duhet me kry. Unë e kam bisedu problematiken e Bovocit unë jetoj atje, problemi aty është që ai nuk është çel asnjëhere dhe planifikim i ketij vitit për vitin e ardhshem ai do të çelet komplet. Mirëpo na do të marrim leje prej qeverisë me nderhy aty sespe nuk është kompetencë e jona.

Z.Ardit Berisha: unë ligjin dhe kompetencat i di jashtëzakonishtë mirë. E di që komuna bashkëpunon edhe me Drinin e Bardhë, edhe me Hidro Drinin, edhe me kompanit tjera rajonale. Ju i keni parapa disa zëra buxhetor për kanalet e ujitjes, e keni kry një pjesë në Kosuriq, nuk është vazhdu qysh duhet ajo pjesë. Në Kryshec ki probleme që 20 vite del uji jashtë shtratit dhe bën dëme, po them urgjentishtë nuk është shumë janë diku 800m në Kryshec, në Kosuriq janë diku 400-500m. Nese nuk është mundësia me u kry krejt normalishtë që duhet të kërkojmë fonde, kërkojmë mbështetjen edhe të qeverisë ose donacione vetem t'a përfundojmë dhe është mirë me përfundu komplet sespe është investim që duhet mbasi kryetari tha se jemi mirë me gjendjen financiare. Pse mos me u kry? Është urgjente përderia keni marrveshje me Drinin e Bardhë mundeni me kry!

Z.Labinot Panxha: meqenëse u përmend vendlindja ime, po dua me ju kujtu të dy kolegëve të mi që proji që kalon përmes fshatit është ndërtu nga komuna, qato metra janë ndërtu nga komuna. Proji i fshatit është ngushtu në vend që me u zgjërë. Nga 6 metra është ngushtu në 3 metra. Po ashtu edhe kolegu Ardit i përmendi se sa nevojiten për me u ndërtu. Proji i fshatit kanë mbet edhe 1000m që duhet me u ndërtu, mirëpo duhet me u zgjërë e jo me u ngushtu. Po ashtu edhe një pru tjetër Bevoci që i thojnë është diku përafërsishtë 1500m që është i pa ndërtuar, i cili është shumë i rezikëshem në momentin që paraqiten vërshimet. Gjithashtu edhe proni që kalon përmes

fshatit i dëmton ato shtëpi ato prona të cilat janë aty përreth. Unë e falenderoj Arditin që e ngriti këtë çështje, sepse kjo çështje çdo dytën seancë është ngritur këtu, mirëpo jemi në rezultat aty ku jemi! Por shpresoj që në këtë mandat kryetari do t'a këtë parasysh dhe do të ndërmerrë hapa të cilët do ta përmisojnë infrastrukturen atje.

Z.Ardit Berisha: Tahiri vjen prej asaj ane dhe kryetari e din. Ky lum i Behocit është shumë i rrezikshëm. Para disa viteve i ka mbytur dy të rinjë të fsh.Qallapek familjes Krasniqi. Është mirë me interevenu dhe me u rregullu. Tahiri e din dhe është dasht me pas parasysh dhe mundet me bë dëme të tjera në të ardhmen.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: për këtë vit është e parapame që me përfundu një pjesë e Çokolices edhe me përfundu kanalin te shkolla “Xhemajl Kada”, edhe e kemi kanalin e Lubeniqit që i mbledh ujërat edhe i qet përtej rruges që po i thojnë Druni i Telit. Për vitin tjetër e dim që duhet me planifiku është kanali prej fshatit Treboviç që shkon deri në fund Nabërgjan dhe derdhet në Dri. Edhe kanali i Behocit që duhet me u trajtu dhe me marrë deri në Gllogjan. Edhe e kemi një pjesë që duhet me u trajtu që shkon prej Kërstovcit në drejtim të Llozhanit edhe ai kanal duhet me u zgjëru sespe druajtë që janë rrit është ngushtu. Këto i planifikojmë sivjet që për tri fronte me i kry këto punë. Nese të hyrat vetanake janë të mira edhe këtë vit ashtu siç kanë qenë në 2025-en, besoj që për vitin 2026 i realizojmë edhe këto tri pjesë që rrezikojnë vërshimin.

19.Shqyrtimi i informatës së kryetarit mbi planin e punës së ekzekutivit për 2026.

Kryetari Gazmend Muhaxheri:është ky raporti i punës që e kemi dorëzu para jush nese ka dikush diqka, mundem me u përgjigj.

20.Shqyrtimi i informatës mbi raportin vjetor të Komunës se Pejës për vitin 2025.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: këtu vetem do të këtë një risi se me rritjen buxhetore që e kemi do t'a ndërtojmë shkollën e re në fshatin Loxhë. Pastaj mbetet shkolla në Llozhan edhe shkolla në Nabërgjan. Nese mundem me gjet mirëkuptim me qeverinë që njëren prej tyre me bo qeveria, nese jo tri vite rend e mbarojmë nga një shkollë dhe i përfundojmë shkollat fillore që janë të nevojshme në komunën e Pejës.

21.Shqyrtimi i raportit informativ i të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2025.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: është raport informativ dhe unë e shpjegova të përmbledhur gjendjen ekonomike. Ndërsa këtu i keni më të detajuar nëpër të gjitha zërat që ka shku komuna. Ajo se qka është ma karakteristike sepse i kemi pas 2 milionë e 300 mijë euro denime gjygjësore të cilat i kanë pengu disa punë për me u realizu. Ka mbet salla e sportit në Gllogjan pa u kry dhe me bartjen që na ka mbet nuk mundet me u qit tenderi as këtë vit, dhe me rritjen buxhetore me dit saktë s aka me na kushtu ajo pjesë e ndërpreme e kishim përfundu këtë sallë të sportit në Gllogjan.

Znj. Gemza Sylejmani: në vitin 2025 keni parapa buxhet për furnizime mjekësore vetëm 118.000euro ndërsa keni shpenzuar vetem 68,443 euro. A mundem me dit se përse është shpenzuar ka pak kur dihet që QKMF në Pejë, nuk janë të furnizuara sa duhet ku ka mungesë të gjërave elementare? Pse nuk është shpenzuar gjithë buxheti i parapar për furnizime mjekësore?

Z.Petrit Loci: sa i përket planifikimit për furnizime mjekësore bëhet vetem për ndërhyrje urgjente. Në këtë rast kur ka mungesë nga lista esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë, pra nga barnatorja qendrore, mungesën e barnave dhe material shpenzues, atëhere bëhet ndërhyrja me mjete buxhetore vetanake. Për këtë arsye planifikohet dhe nuk do të thotë që të shpenzohet i gjithë buxheti, por vetem në ato raste kur paraqitet nevoja për plotësim e këtyre. Mungesat e caktuara të QKMF –së janë direkt përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Barnatores Qendrore. Pra çdo mungesë duhet të adresohet në listen esenciale e cila menaxhohet nga Ministria e Shëndetësisë.

Z.Naim Bytyqi: nuk po ndalem shumë në këtë raport sepse kam qenë edhe në mandatin këtu çdo tre muaj kemi diskutuar pikë për pikë. Mirëpo meqenëse drejtoresha është këtu unë e kisha lut me marrë pjesë gjithmonë sidomos kur është tremujorishi i raportit. Për shaka se dikujt mundet me ju dok e kotë bashkëbisedime që i kemi bë, mirëpo na shpesh herë i kemi përmisuar. Ka pas problem me kode ekonomike, ka pas probleme me tejkalim të shpenzimeve dhe shpesh here i kemi diskutu dhe kemi arrit një pikë të përbashkët. Kishte me qenë mirë se sa here që kemi raport i tremujorit me pas një bashkëbisedim që me mujt me i përmisu ato situata për shkak se edhe qytetarët kanë nevoj me dit se takasa e tyre ku po shkon dhe si po trajtohet.

22.Shqyrtimi i informatës mbi realizimin e Planit të Prokurimit për vitin paraprak.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: a ka dikush diqka për diskutim rreth kësaj informate, nese jo po kalojmë tek pika tjetër.

23.Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar:

Nuk ka pasur.

24.Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

Z.Shaban Ramaj: një pyetje për QKMF-të deshta me dit shpenzimet që i paguajnë veteranët e këto organizatat e dalur nga lufta pse të do Qkmf pagujnë e te do Qkmf jo?

Ku është problemi a i udhëheq një njeri këtu apo kanë dallime? Ndërsa çështja e dytë është tek administrata, a kish pas mundësi që kategoritë e dalur nga lufta me u liru prej pagesës kur shkon me nxjerrë një certifikatë të lindjes ose shërbime tjera?

Znj. Hidajete Nikçi: unë e kam një pyetje për asfaltimin e rruges tek Kalaja në qytet, e dim që aty kockat janë heq para fushate dhe vetem një pjesë e saj është asfaltu, ndërsa pjesa tjeter ka mbet në gjendje të mjerushme.

Znj.Hidajte Krasniqi: drejtori i shëndetësisë tha që kërkesat për furnizim varen nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga lista esenciale. Mendoj që nuk po bëhet një plan i duhur se nese e keni planifiku planin mirë, atëhere nuk duhet që gjytpëren me ble pacienti. Ndërsa lista esenciale nese bëhet një planifikim i mirëfilltë që kjo po na paraqitet që çdo vit ka mungesë edhe gjytpëra shpuse edhe fllasteri edhe gjërat elementare. Pse nuk bëhet një planifikim i duhur që kjo mungesë mos të jetë gjithmonë evidente?

